



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

KRYETARI

V E N D I M

Nr. 09 Datë: 22.07.2021

PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KESHILLTARES TE KESHILLIT TE QARKUT SHKODËR Znj. JETMIRA RRABOSHTA

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021, në mbështetje të ligjit 139/2015 “për vetqeverisjen vendore” nenit 49 pika b) i ligjit, neni 75 pika c) dhe neni 77 pika j) Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, ” *për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19*”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “*për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...*”

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relativitetit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **10 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**.

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I ;

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares të qarkut Shkodër znj. Jetmira Rraboshta si pasojë e humbjes së mandatit si anëtare e këshillit bashkiak Shkodër, si rrjedhojë e dorëheqjes se saj.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.





KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

RELACION

PËR VENDIMIN

PËR MBARIMIN E PARAKOHSHEM TË MANDATIT TË KËSHILLTARES TË QARKUT, SHKODËR ZNJ. JETMIRA RRABOSHTA.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49 pika b) i ligjit, neni 75 pika c) si dhe neni 77 pika j).

Pranë Këshillit të qarkut Shkodër është depozituar kërkesa e dorëheqjes e anëtares së KQSH-së Znj. Jetmira Rraboshta prot.164/1 datë 27.05.2021 si rrjedhojë e marrjes së mandatit të deputetes në Kuvendin e Shqipërisë, kjo si shkak i krijimit të vakancës në listën e partisë Socialdemokrate. Gjithashtu është përcjellë edhe shkresa zyrtare nr.prot 11789 date 12.07.2021 nëpërmejt të cilës është depozituar Vendimi i Këshillit Bashkiak Shkodër nr.34 dt: 02.07.2021. Me anë të të cilit është miratuar dorëheqja e anëtares së Këshillit Bashkiak Shkodër **Znj. Jetmira Rraboshta**. Bazuar në ligj si pasojë e humbjes së mandatit si anëtare e Këshillit Bashkiak rrjedhimisht e humbet edhe mandatin si anëtare e keshillit të qarkut Shkoder.

Si pasojë propozoj të shtohet në rendin e ditës së mbledhjes së KQSH-se edhe Projekt-vendimi për Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares së qarkut Shkodër znj. Jetmira Rraboshta si pasojë e humbjes së mandatit si anëtare e këshillit bashkiak Shkodër, kjo si rrjedhojë e dorëheqjes së asaj.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Edita SHOSHI